



REPubLIKA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI

**DEKRET  
PER KTHIMIN E LIGJIT PER RISHQYRTIM NE KUVEND**

Në mbështetje të nenit 85, pika 1, të Kushtetutës

**DEKRETOJ:**

Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr 8480, datë 29.4.1999 “ Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe të enteve publikë “

Tiranë, më 10.5.1999  
Nr i dekretit : 2363

**PRESIDENTI I REPUBLIKES  
REXHEP MEIDANI**

27

## RELACION PER MOTIVET E KTHIMIT TE LIGJIT

Ligjin nr 8480, datë 29.4.1999 “ Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” vendosa ta kthejë për arsyet e mëposhtme:

1. Është e domosdoshme që ligji të përcaktojë qartë dhe pa ekuivoke organet kolegjiale që detyrohen të zbatojnë rregullat e vendosura në të. Kjo për faktin se ndërsa janë të qarta termat e përdorura në ligj “organe kolegjiale të administratës shtetërore”, nuk ndodh e njëjta gjë me termat “organe kolegjiale te enteve publikë”. Në nenin 1 të ligjit është bërë përpjekje për të dhënë përkufizimin se kush do të quhen “ente publikë”, duke i barazuar ato me subjektet e të drejtës publike. Por, nëse do të shtrojmë pyetjen se çfarë quhen “subjekte të së drejtës publike”, përsëri nuk do të kemi përgjigje të saktë. Prandaj është e domosdoshme që vetë ligji duhet të përcaktojë se kush do të quhen “ente publikë”. Ky përcaktim ka rëndësi të madhe për të shmangur në praktikë lindjen e konflikteve të panevojshme për shkak të mosrespektimit të rregullave që parashikohen në këtë ligj.

2. Në përgjithësi, organet kolegjiale të administratës shtetërore funksionojnë në bazë të rregullave të përcaktuara në akte normative (ligje., apo Vendime të Këshillit të Ministrave), si dhe në bazë të rregulloreve të nxjerra në bazë e për zbatim të këtyre akteve. Sot kemi një sërë organesh kolegjiale që funksionimin e tyre e kanë të rregulluar me akte të vecantë. Kështu mund të përmëndim aktet që rregullojnë funksionimin e bordeve apo të këshillave mbikqyrës, si psh të Bankës së Shtetit, Këshillat e Rregullimit të Territorit, të Radio Televizionit Publik, INSIG-ut etj. etj. Nëse ky ligj do të hyjë në fuqi në gjëndjen që është miratuar, do të ndodhin përplasje me ligjet apo aktet e tjerë të miratuar më parë. Në këto kushte me të drejtë mund të shtrohet pyetja :Çfarë rregullash do të kihen parasysh në funksionimin e këtyre organeve kolegjiale, ato që parashikon ky ligj apo ato të akteve përkatëse të tyre. Ligji duhet ta zgjidhë këtë çështje